



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.09.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.09.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Ekonomik N.SH.T.Viktori Com.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –V-së , lot 3, me Nr. të Prok: 632-21-585-5-1-1.** nxjerr:

V E N D I M

- II. 1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “**N.SH.T.Viktori Com,** e dt. **17.09.2021,** lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –V-së , lot 3, me Nr. të Prok: 632-21-585-5-1-1 dhe Nr. Brendshëm 632-21-005-511., kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES,** të datës 15.09.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i publikuar me datë: 15.09.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

- I. Operatori Ekonomik “**N.SH.T.Viktori Com** me datë 17.09.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –V-së , lot 3, me Nr. të Prok: 632-21-585-5-1-1 dhe Nr. Brendshëm 632-21-005-511.**
- II. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.09.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë është i pa bazuar për arsye se Autoriteti Kontraktues deri në momentin e shpalljes së Njoftimit për dhënje mund t’i referohet Operatorit ekonomik të caktuar dhe deri në një nënshkrim të kontratës nuk ka obligime kontraktuale.

Gjithashtu sqarojmë se çdo dokument i kërkuar secilit prej operatorëve, është bërë përmes sistemit d.m.th. nuk ka asgjë tinzare dhe favorizuese për asnjë operator ekonomik;

Sa i përket pretendimit tuaj të dytë lidhur me lisën e makinerive, sqarojmë se nuk përbën shkelje por është vetëm devijim minor neni 59 pika 4 e LPP-së:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendimi juaj i tretë se Operatori Ekonomik Berisha Com, nuk e ka të shënuar emrin dhe numrin e aktivitetit nuk qëndron dhe është i pa bazuar, sepse në dosje të tenderit tek deklarata nën betim nuk është shënuar emri dhe numri i aktivitetit:

Aneksi 2

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjohave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Për pretendimin tuaj të katërt sqarojmë se Komisioni i parë i vlerësimit ju ka shpallur juve fitues duke ju marrë për bazë situacionet, kurse gjatë ri-vlerësimit është konstatuar se ky ka qenë lëshim i komisionit paraprak sepse në dosje të tenderit është kërkuar që të prezantohen referenca për punët e përfunduara:

<p>Lot-III-Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 290,000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të minimum 60% të vlerës së kërkuar kontrata të natyrës së ngjajshme.</p>	<p>Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha punet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkruara, duke shprehur punët e kryera shkruar në kontratë, datën e pranimit ose certifikatën e ekselencimit të mirë të punëve – (si paku një referencë ose raport të pranimit të punëve e cila përputhet me listën e dorëzuar, në rast kur OE, prezanton kontratarëncën me OE private atëherë OE duhet të prezantohej situacionet e nënshtruarat së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.</p>
---	--

Prandaj edhe ky pretendim i juaji është i pajzuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankesë mund të paraqesësh pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



 Baiton Gurtaj

 Mëmbër i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatori Ekonomik;
 Zyrës së Kryeshtetë të Komunës;
 Të gjitha palëve të interesuara;
 Arkivit të Komunës